



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Mr. 3693/1 Prot
Dt. 12.07.22



Nr. 443/1 Prot.

Shkodër, më 8.07.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 39, datë 27.06.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VOU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27, pika 6, neni 54, shkronja “n”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 30, pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të ligjit nr. 9693 “Për fondin kullësor”, neni 26, shkronja “c”, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”, të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau Dejës nr. 3690 prot., datë 27.06.2022 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 27.06.2022”, shqyrtoi *VKB Vau Dejës nr. 39, datë 27.06.2022 “Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor e kullësor për vitin 2022”.*

Për sa trajtuar më sipër, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 39, datë 27.06.2022



Për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2022

Këshillit Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 27.06.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.1,a, nenin 27 pika 5, nenin 54,shkronja n të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,i ndyshuar, Ligjit Nr.57/2020, datë 30.4.2020: “Për Pyjet”,neni 30,pika c; Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”,Ligjit Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor” i ndryshuar. Ligjit Nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;Ligjit Nr. 152, datë 21.12. 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”;ligjit nr 45,date 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”;VKM 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”,me shumicë votash të këshillit Bashkiak :

V E N D O S I

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2022.
2. Efektet: Jep impaktë pozitive në prandalimin dhe mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave nga zjarret.
3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Pyjeve,Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Bashki.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R

Mark Bisha

**Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija**



Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 04.07.2022